



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1517/1 prot.,

Datë 12.06.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-38424-02-18-2025, me objekt: “*Furnizim Vendorsje pajisje mjekesore Angiografi, ne Qendren Spitalore Rajonale te Tiranes “Shefqet Ndroqi”*”, me fond limit 66.192.000 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 19.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Medfau” SHPK me NUIS J93610823R dhe adresë: Lagjja 5, Kavajë.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”, me adresë: Rruga “Shefqet Ndroqi” Sauk, Tiranë

Në datën 12.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2025/5415, protokolluar me nr.1517/2025 prot, datë 12.06.2025, i operatorit ekonomik “Medfau ” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me nr. REF-38424-02-18-2025, me objekt: “*Furnizim Vendorsje pajisje mjekesore Angiografi, ne Qendren Spitalore Rajonale te Tiranes “Shefqet Ndroqi”*”, me

fond limit 66.192.000 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 19.05.2025 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Rajonale e Tiranës “Shefqet Ndroqi”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe kërkohet anulimi i anulimit të kësaj procedure.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”,* Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Medfau” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, të cilat kundërshtohen nga ankimuesi.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Medfau” SHPK nga KVO-ja, si më poshtë vijon:

- Në zbatim të ligjit nr. 162/2020 për “Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 për “Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, si dhe Neni 93, Pika 3 e ligjit 162/2020 “Oferta anomalisht e ulët”, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe argumentimit të dhënë nga shoqëria “Medfau ” SH.P.K., skualifikohet pasi argumentimi nuk është shoqëruar me dokumentacionin shpjegues sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu në dokumentacionin shoqërues të paraqitur nga Operatori ekonomik rezulton e zhdoganuar pajisja mjekësore Scanner dhe jo pajisja mjekësore Angiograf ,objekt prokurimi..”

Publikuar në rregjistrin e ankesave me datë 12.06.2025

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro